i. Çertifikate **ISO 9001:2015 "Per menaxhimin e cilesise"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.

ii. Çertifikate **ISO 14001 :2015 "Per sisitemin e Menaxhimit te Mjediset"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.

iii. Çertifikate **ISO BS OHSAS 18001 :2007 "Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune"** objekt i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.

iv. Çertifikate **EN-ISO 22000 :2005 "Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.

Ne rast bashkimit te operatoreve ekonomik secili prej anetareve te grupit duhet te paraqese keto çertifikata. Nese çertifikatat e lartpermendura jane ne gjuhe te huaj ato duhet te jene te perkthyer ne gjuhen zyrtare shqipe dhe te noterizuara njesia m, e origjinalin.

1. Operoret ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates objektin njesi tregtare mishi e pershtatshme per tregtimin e mishit dhe nenprodukteve te tij objekt prokurimi e pajisur me Leje Higjenosantare me dhome frigoriferike ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontraten e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet.

2. Operoret ekonomik duhet te jene te paisur me liçens nga QKB kodi II.I.B "Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore".

3. Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kene ne pronesi ose me qera stalle per mbashtrimin e bagetive e paisur me liçens nga QKB ose kontrate furnizimi per produktet objekt prokurimi e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit.

4. Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kene ne pronesi ose me qera stalle per mbashtrimin e bagetive e paisur me liçens nga QKB ose kontrate furnizimi per produktet objekt prokurimi e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit.

5. Operoret ekonomik duhet te jene te pajisur me liçens leshuar nga QKB per prodhimin e bukes ose kontrate furnizimi per produktin objekt prokurimi e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit.

6. Operoret ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates objektin njesi tregtare ushqimore e pajisur me Leje Higjenosantare ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontraten e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet .

7. Operoret ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates

Dokumentat Standarde të Tenderit

objektin njesi tregtare ushqimore e pajisur me Leje Higjenosanitare ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontraten e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet .

8. Operatoret ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates objektin njesi tregtare ushqimore e pershtatshme per tregimin e bylmetrave objekt i prokurimit e pajisur me Leje Higjenosanitare ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontraten e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet.

9. Operatoret ekonomik pjesmarres duhet te kene kontrate furnizimi per produktet objekt prokurimi (bulmetra) e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me licensen leshuar nga QKB te furnizuesit dhe leje higjeno –sanitare.

10. Raport-Analiza te produktit qe prokurohet per vitin 2020 ku te perfshihen te gjithë treguesit e percaktuar ne specifikimet teknike.

11. Operatoret ekonomik duhet te kene te punesuar per periudhen maj 2019-2020 jo me pak se 5 (pese) punonjes te vertetuar me list-pagesa dhe vertetim per numrin mesatar te punonjesve te leshuar nga Dega e Tatim Taksave si dhe librezja shendetesore per pese punonjesit.

12. Operatoret ekonomik duhet te paraqesin nje çertifikate qe verteton se subjekti eshte inspektuar nga ana e AKU viti 2020

13. Operatoret ekonomik duhet te kete per gjashte muajt e fundit nje specialist veterinar dhe specialist teknolog te vertetuar kjo me kontrate te rregullt pune.cv.diplome listpagesat per periudhen e mesiperme.

14. Operatoret ekonomik pjesmarres ne tender e mesiperme duhet te disponojne 2 mjete te pershtatshme per transportin e produkteve objekt prokurimi ku njeri prej tyre duhet te jete frigoriferik te cilet duhet te jene te paisur me leje higjeno-sanitare dhe te figuroje te rregjistruar ne QKB e ofertuesit. Mjetet duhet te jene te pajisur me (leje qarkullimi) akt kolaudimi, policen e sigurmit te mjetit, taksen si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia per vete ose te trete.

15. Per arsye se furnizimi do te jete ditor dhe ne ore te percaktuar sipas grafikut bashkengjitur DTS kerkohet qe operatoret ekonomik pjesmarres ne tenderin e mesiperme duhet te ushtrojne aktivitetin e tyre ne qytetin ku ndodhen institucionet e varesise ose te kene pike kontakti ne qytet si adrese te dyte, te vertetuar me dokumentacion perkates ligjor, i rregjistruar ne QKB e ofertuesit si adrese e dyte ushtrimi aktiviteti si dhe te jete i pajisur me leje higjeno-sanitare..

16. Operatoret ekonomik qe kane patur marrdhenie kontraktuale te meparshme me Bashkine Shkoder dhe te cilet kane rezultuar me mospermbushje te suskseshme te objektit dhe detyrimve perkatese te kontrates, do te skualifikohen.

17. Diten e hapjes se tenderit Operatoret ekonomik ofertues te bejne paraqitjen e mostrave per çdo produkt dhe artikull.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE PER ARTIKUJ TE NDRYSHEM USHQIMORE

BUKE

Buka e grurit do te prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete i fresket, me ngjyre, ere, shije dhe lageshtire konforme standarteve perkatese te miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj. Buka duhe te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjeftueshem. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet te jete konforme standartit teknik te prodhiit te saj. Korja e bukes – duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte, ne te gjithe siperfaqen. Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithe vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane magazinave te Drejtorise se Çerdheve dhe Kopshteve Shkoder sipas kerkeses. Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster dhe te siguroje mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

MISHI

Mish vici i fresket

Mishi duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Te jete mish i freket vendi, pa ere, te jete i forte, kufome ose kofshe e pasme (trung), me peshe jo me te madhe se 100 kg, Pamja e jashtme te jete me siperfaqja e jashtme e mbuluar me nje cipe te holle tharje, siperfaqja e mishit te ftohur menjehere pas prerjes te jete i tejdukshem, tendinat te jene te ndritshme, elastike dhe te forta. Mishi te jete me ngjyre roze dhe i dhjemit te jete me ngjyre te bardhe. Me ere te kendshme, karakteristike e llojit. Çdo furnizim damkoset me vulen e

kontrollorit veterinar e sanitar dhe me vulen e llojit e te cilesise se mishit. Çdo parti mishi shoqerohet me çertifikaten veterinare me te cilen vertetohet gjendja e tij e mire shendetsore per shitje ne treg (konsum). Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit.

BULMETRA

Gjalp

Gjalpi kerkohej te jete prodhim vendi me baze qumesht lope , delje ose dhie, i fresket. Ngjyra te jete e verdhe karakteristike e gjalpit te lopes ose e bardhe karakteristike gjalpit te dhise dhe deles. Nuk lejohen perberes te tjere, njolla te erreta karakteristike e gjalpit jo te fresket. Shija te jete e kendshme, pa erera te tjera jo natyrale. Ambalazhimi te jete me kuti kartoni ne brendesi te mbeshtjelle me leter celofoni standarte 10, 20 ose 30 kg. Malli te shoqerohet me certifikate te cilese sipas standarteve te miratuara. Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit dhe data e skadences. Furnizimi me djathe dhe gjalpe do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit

Qumeshti

Te jete i fresket, i pasterizuar dhe i sterilizuar. Te mos kete ne permbajtjen e tij lende konservuese dhe neutralizuese. Te plotesoje treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike. Ambalazhimi te jete brenda kushteve higjeno-sanitare. Ruajtja dhe transportimi me temperature 2 deri ne 8 grade. Permbatja e yndyres deri ne 2-3 %

Djathe i bardhe

Djathi kerkohej me baze prodhim neprodukt i qumeshtit te , deles, ose dhise. Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumesht pluhur ose te kodensuar. Ngjyra te jete sipas llojit te qumeshtit , i deles dhe dhise te kete ngjyren karakteristike te qumeshtit i bardhe (kur djathi eshte prodhuar me baze qumeshti delje ose dhie,) Lejohet djathe me perqindje yndyre jo me shume se 3 %. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze karakteristike e djathit te stazhionuar mire. Sasia e kripes te jete normale. Shija te jete e mire karakteristike e djathit normal pa erera te tjera jo te kendshme. Ambalazhimi te jete i shoqeruar deri 10 – 14 % kripe deti te jete i abalazhuar ne kuti brenda standarteve, kutite te jene 1 kg. Nuk lejohet me afat skadence me shume se nje vit. Malli te jete i shoqeruar me certifikate te cilesise dhe te standarteve te miratuara. Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, data e stazhionit dhe data e skadences.

USHQIME TE NDRYSHME

Vezet

Veze pule , te pastra e jo te plasaritaira te cilesise se pare.Te jene prodhim i fresket brenda dy ditesh te shoqeruara me dokumetin perkates te prodhimit.Te jene te amalazhuara me karton fole dhe ne kuti kartoni. Jo me te vogla se 50-60 gram .

Makarona.

Ngjyra e e bardhe ne te verdhe e cilesise se pare.E paketuar ne pako gjysem kilogrameshe dhe me etiken perkatese te garancise dhe te prodhuesit.Pako te pa demtuara. Ere e kendeshem e makaronave te fresketa gjate gatimit.Tipi makaronit do te jete sipas kerkeses per natyren e gatimit.Nuk perjashtohet klerkesa llojit te prodhimit. . . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Miell

Te jete i paster i cilesise se pare i stazhionuar rreze 70 , pa sheja te mykut e po te tjera te kesaj natyre, i bardhe .I paketuar ne pako 1 kg me etiketen e prodhuesit dhe afatet e garancise dhe te futura ne kuti kartoni.Nuk perjashtohet dhe marka e prodhimit ne kerkese per lloje te ndryshem te gatimit.
. Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Oriz

I cilesise se pare.te jete i paster pa lende te huaj, i imet me kokerr te plote te pa thyer ,i paketuar ne cese nje kilogrameshe dhe ne kuti kartoni me etiken e prodhuesit dhe te afatave te garancise.Pa shenja te ndrysheme myku apo te tjera te kesaj natyre prishjeje.Ambalkazhimi te mos jete i demtuar.

Ne pershtatje me natyrene e ushqimit te kijet parasyshe marka qe do te kerkoet. . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Miell orizi

te jete cilesor, i etiketuar sipas standartit shteteror. dhe me date skadence nje vit nga data e furnizimit. Ambalazhimi te jete me pako 250 g

Sode Buke

Te jete pluhur me ngjyre te bardhe, me eren karakteristikete sodes se bukes.Te mos kete lageshtire dhe erera te huaja. Ambalazhimi: me pako ne qese cellofoni me peshe 0.1kg..

Sheqer

Ngjyre te bardhe me shkelqim,i embel te tretet lehtesisht .

Te jete i cilesise se pare me kristale te imta te mos kete lageshtire(deri 0.074).I paketuar ne paketa nje kilogrameshe me etiken e prodhuesit ku te kete dhe afatet e skadences dhe i sitemuar ne kuti kartoni. Ambalazhimi te mos jete i demtuar . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Çokokrem

Te jete cilesi ekstra,mase homogjene ne trajte kremi me kakao,lajthi,qershi, dhe qumesht pluhur,pa konservues. Perberesit: Qumesht pluhur, sheqer, yndyrna 26% Kakao ,lajthi 10 – 12%. Ambalazhimi hermetik me vazo plastike me peshe 1 Kg. me etikete. . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Vaj gatimi

Vaj i preferuar prej luledielli me pamje te carte e te kthjellet .Te mos kete depozitime ,te jete me ngjyre te verdhe te paster.I ambalazhuar ne ene nje litershe me etiketen e prodhuesit ku te dallohet shenja e garancise dhe treguesit cilesore.Pa ere gjate gatimit Nuk perjashtohet dhe perzgjedhja e markes se tije.kur cilesia nuk eshte e kenaceshme . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Vaj ulliri

te jete nenprodukti ullirit , me aciditet te ulet i kulluar, i rafinuar, te mos kete papasterti. Ambalazhimi te jete ne shishe qelqi 1 lit. dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit..

Kripe

E barshe e plote, me kristale te imeta , e treteshme lehte ne uje dhe ne gjelle. E paketuar ne cese plasmasi te rregullta (te pa demtuara) 0.5 kg dhe e ambalazhuar ne kuti kartoni. Te jene te etiketuara me te dhenat e garancise dhe te prodhuesit . . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

FRUTA E ZARZAVATE

Molla

Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije te kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra, te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht,por pa difekte rreth bishtit. Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi. Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy njolla jo te zeza,te vogla,te lehta per kokerr. Nuk lejohen te krimbura. Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekurenuk lejohen. Gunga, njolla ne lekure nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrrs lejohet deri ne ¼ e siperfaqes se frutit.

Portokalli

Kerkohet cilesi e pare, i fresket, me zhvillim normal, te shendoshe e me bisht. Pra dhe mbas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, perkatesisht 5 & 20 %, me pjekuri teknike te plote. Ngjyra te jete karakteristike e kultivarit, e verdhe ne portokalli, me ere karakteristike dhe shije te embel ne te athet, pa shije te hidhur. Madhesia e kokrres te jete jo me pak se 70 mm. Demtime mekanike nuk lejohen. Te prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Lende te huaja nuk lejohen. Gervishje ne siperfaqe por pa prekur tulin, nuk lejohen. Zbutje te kokrrave, ngrirje dhe lagie te siparfaqes se tyre nuk lejohen.

Banane

Kerkohet cilesi e pare e fresket e pjekur mire , me ngjyre te verdhe, pa shenja dhe demtime pa shtypje

Zarzavate

Purrinj

Kerkohet cilesia e pare, te jete i fresket, i njome, i paster, me gjyre te bardhe e jeshile, i pa vyshkur dhe i lare me uje te pijshem. Diametri ne pjesen me te trasse te jete mbi 2.5-3.5 cm. Gjatesia e kercellit te jete 25-45 cm. Gjatesia e gjethit nga rozeta te jete jo me shume se 20 cm. Sistemi rrenjor te jete jo me shume se 1 cm. Demtime e semundje nuk lejohen.

Domate

Kerkohet domate e cilesise se pare, ku te jene te fresketa, me forme tipike te kultivarit, te plota, te pastra, te pa vrara, te pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, te pa prekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe te pa lagura. Pjekuria duhet te jete normale, me ngjyre te kuqe, lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate te tejppjekura, te zbutura e te vyshkura. Demtime e semundje nuk lejohen. Te plasura e te vrara lehtesisht per llojet e mesme e te vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lengu. Madhesia e kokrres te jete: Per te hershmet 3-4 cm. Per te mesmet e te vonat 7 cm.

Speci

Kerkohet cilesia e pare, te jene me forme e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen demtime jo me shume se 3 %. Shija te jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges. Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm

Karrota

Lloji :Karrota per treg cilesia e pare. Kerkesat cilesore : Pamja e jashtme: Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte.

Patellxhana

kerkohet cilesia e pare, te jene te fresket, te paster, me siperfaqje te lemuar, me ngjyre te zeze ne manushaqe, me pjekuri normale, me flete jeshile me nuanca te dobeta manushaqe, te pa

vyshkura. Demtime te ndryshme e semundje nuk lejohen. Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm. Gjatesia e bishtit te jete jo me shume 4 cm.

Spinaq

Kerkohet cilesia e pare, te jete I fresket I paster me gjethe jo te vyshkura, ngjyra e gjethit te jete jeshil, pa semundje, Forme tipike kultivarit.

Laker

Kerkohet cilesia e pare, te jene te zhvilluara, me mbeshtjellje fletesh, e forte ne prekje. Lejohen lakra te pa ngjeshura deri ne 5 % te partise. Te jene te pastra dhe me 2-3 gjethe te gjelbera, te lidhura me koçanin i cili tejete deri ne 3 cm. Lejohen deri ne 5 % e partise me demtime te lehta mekanike, te çara lehtesisht e te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma. Me semundje nuk lejohen. Pesha e kokrrës te jete jo me pak se 1 kg per lakren e hershme dhe per pjekje te mesme e te vona jo me pak se 1.5 kg

Patate

Te e cilesise se pare me diameter jo me te vogel se 5 cm , e pa demtuar apo e kalbur. e paster me ngjyre e bardhe ne te verdhe.

Madhesia mesatare , e re ne prodhim, te jete normale ne gatim

E ambalazhuar ne thase jo te mbydhur(tip rrjete)ne peshe deri 15 kg.

Preferohet prodhimi vendas.

Lulelaker

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos kete shenja demtimi, te kete ngjyren e bardhe karakteristike te saj, madhesia e lulelakres te jete me peshe mesatare.

Borokoli

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos kete shenja demtimi ose vyshkje te kete ngjyren jeshile karakteristike te saj.

Kunguj

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos te shtypur ose me shenja demtimi ose kalbur, ngjyra te karakteristike e kungullit. Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm.

Salce

Lloji i salces te jete domate, me ngjyre te kuqe te domates.

Te kete eren karakteristike te domates, pa shenja te tjera.

Te jete ambalazhuar ne kuti teneqe me etike prodhuesi dhe me garncine e shenuar Ambalazhimi 500 deri 700 gr . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Qepe

Te jete e thate plotesisht ,e paster

Ne madhesi normale jo e vogel me diameter jo me te vogel se 5 cm, e pademtuar apo te kalbura.

Te jen e ambalazhuar ne thase jo te mbydhur(tip rrjete) ne peshe deri 15 kg

Fasulja

Me kokrra te plota dhe mesatare, te shendosha, te paprekura nga miza, pa erë myku dhe lende te huaj. E etiketuar dhe ambalazhuar sipas standartit,te jete product vendi e fresket dhe e re dhe te zihet shpejt.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| | | |
|-------------------------|----------------------------|---|
| Mall: | | Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes |
| Kuadër | | |
| Kontrata Nr. | Titulli i Kontratës | Përshkrim i shkurtër i kontratës |
| 01 | | |
| 02 | | |
| 03 | | |
| ... | | |

Shtojca 12 Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit

SASIA DHE GRAFIKU I LEVRIMIT
viti
2020
(Çerdhe e Kopshte)

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | | |
|---------|--|------------------|------------|-------------|--------|-----------|-------|
| Puna nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Sasia | Totali | Çmimi | VLERA |
| | I Mallit | e Matjes | Çerdh e | Kopsht e | | per njesi | |
| 1 | Buke | kg | 1500 | 3500 | 5000 | | |
| 2 | Mish | kg | 1300 | 2200 | 3500 | | |
| 3 | Sheqer | kg | 400 | 800 | 1200 | | |
| 4 | Oriz | kg | 600 | 1500 | 2100 | | |
| 5 | Makarona | kg | 600 | 1600 | 2200 | | |
| 6 | Miell | kg | 200 | 1800 | 2000 | | |
| 7 | miell orizi | kg | 500 | 0 | 500 | | |
| 8 | Kripe | kg | 140 | 250 | 390 | | |
| 9 | Vaj lule dielli | liter | 300 | 1000 | 1300 | | |
| 10 | Vaj ulliri | liter | 209 | 254 | 463 | | |
| 11 | Gjalp | kg | 300 | 400 | 700 | | |
| 12 | Qumesht | liter(kuti) | 7000 | 10000 | 17000 | | |
| 13 | Djathe I bardhe (kuti) | kg | 300 | 1200 | 1500 | | |
| 14 | Veze | kokerr | 1821 | 10100 | 11921 | | |
| 15 | Salce | kuti | 250 | 500 | 750 | | |
| 16 | sode buke | 0.5 kg | 0 | 55 | 55 | | |
| 17 | Patate | kg | 1000 | 1800 | 2800 | | |
| 18 | Qepe | kg | 250 | 450 | 700 | | |
| 19 | Karrota | kg | 450 | 450 | 900 | | |
| 20 | Fasule | kg | 0 | 199 | 199 | | |
| 21 | Çokokrem | kuti (400gr.) | 0 | 400 | 400 | | |
| 22 | Zarzavade(purri,kunguj (domate,speca) patligjana,spinak laker,lule laker, brokuli | kg | 599 | 2400 | 2999 | | |

Dokumentat Standarde të Tenderit

| | | | | | | | |
|----|------------------------------|------|-----|------|------|--|--|
| | etj. | | | | | | |
| 23 | Banane | kg | 600 | 0 | 600 | | |
| 25 | Fruta(molla,portokalla etj., | kg | 0 | 2400 | 2400 | | |
| 26 | Qese Plasmasi | pako | 100 | 205 | 305 | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | Çmimi neto | | | | | | |
| | T.V.SH.(%) | | | | | | |
| | Çmimi Total | | | | | | |

Afati I levrimit :

Nga lidhja e kontrates deri me 31.12.2020

Dorezimi I mallrave do te jete ditore per mallrat qe prishen dhe per mallra te tjere mujore ose sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor

Dokumentat Standarde të Tenderit

| | | | | | |
|----------------|--|--|--|--|--|
| Çmimi Total | | | | | |
|----------------|--|--|--|--|--|

Afati I levrimit :

Nga lidhja e kontrates deri me 31.12.2020

Dorezimi I mallrave do te jete ditore per mallrat qe prishen dhe per mallra te tjere mujore ose sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor

SASIA DHE GRAFIKU I LEVRIMIT

SASIA E MALLIT QE KERKOHET **viti**
2020 **(Kopshte)**

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|----------------|-------------------|-----------------|--------------|------------------|--------------|
| Puna nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Çmimi | VLERA |
| | I Mallit | e Matjes | | per njesi | |
| 1 | Buke | kg | 3500 | | |
| 2 | Mish | kg | 2200 | | |
| 3 | Sheqer | kg | 800 | | |
| 4 | Oriz | kg | 1500 | | |
| 5 | Makarona | kg | 1600 | | |
| 6 | Miell | kg | 1800 | | |

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Dokumentat Standarde të Tenderit

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

